

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS**  
**MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE I**  
**MINISTRY OF INFRASTRUCTURE**

Nr./No. Org. / Org. Jednica / Org. Unit: **KM-MIT**  
 Nr./No. Fajevë / Stranica / No. Pages: **1**

Nr./No. Prot. / Broj Prot. / Prot. No.: **240/19**  
 Data / Datum: **19.04.19**

ADRESHTIMI: / A



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS**  
**MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE I**  
**MINISTRY OF INFRASTRUCTURE**

Nr./No. Org. / Org. Jednica / Org. Unit: **01**  
 Nr./No. Fajevë / Stranica / No. Pages: **01**

Nr./No. Prot. / Broj Prot. / Prot. No.: **4203**  
 Data / Datum: **23.04.19**

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada-Government**  
**Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit**  
**Ministarstvo Infrastrukture i Transporta**  
**Ministry of Infrastructure and Transport**

Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit , në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) , të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) dhe nenin 38 (paragrafi 3) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), Rregulloren Nr.26/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 5 dhe 21 të Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërrurban të udhëtarëve me autobus, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2016 dhe rekomandimit të komisionit profesional, nxjerr këtë:

**VENDIM**

**I. Aprovohet** kërkesa nr.1994 e operatorit të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus NSHT "Mendi Tours" me seli Prizren për marrjen e nisjes në relacionin Prizren - Xërxë - Rahovec - Prizren dhe anasjelltas me nisje (09:35 - 10:45).

**Arsyetim**

Pas shqyrtimit të aplikacioneve dhe verifikimit të dokumentacionit dhe shkresave të tjera të lëndës dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi repektivisht Ligjin nr.04/L-179 për Transportin Rrugor në mbështetje të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërrurban të udhëtarëve me autobus i plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin Administrativ nr.06/2016, është konstatuar që operatori transportues rrugor të udhëtarëve me autobuNSHT "Mendi Tours" me seli Prizren, ka plotësuar kushtet ligjore për ndarjen e

nisjeve të lira në relacionin e lartëcekur të përcaktuara sipas nenit 8 të U.A nr. 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin nderurban të udhëtarëve me autobus si dhe kushtet e shpalljes publike për marrjen e nisjes në relacionin Prizren - Xërxë - Rahovec - Prizren dhe anasjelltas me nisje (09:35 - 10:45).

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë, është vendosur si në dispozitiv.

### **Këshilla Juridike:**

Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtrojë ankesë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e publikimit të vendimit.



I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Kabinetit të Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Operatorit Transportues;
- Arhivit.